



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01.Nr. 16-30564/15
Kaçanik, 29. 09. 2015

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040- Për Vetëqëverisjen Lokale(Gazeta Zyrtare Nr. 28 e datës 4 qershor 2008), lidhur me nenin 19 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-233- Për Mbrojtjen e Natyrës (Gazeta Zyrtare Nr. 85 e datës 9 nëntor 2010), si dhe Rekomandimit të Agjensionit për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë Nr.3644/15, të datës 14.07.2015, i cili vepron në kuadër të MMPH, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 29 shtator, 2015, mori këtë:

VENDIM

Për mbrojtjen e vlerës së natyrës të trungut të qarrit (*Quercus cerris*) në fshatin Kovaçec si monument i natyrës

1. Me këtë Vendim merren nën mbrojtje vlerat e natyrës Trungu i Qarrit (*Quercus cerris*) në fshatin Kovaçec- Komuna e Kaçanikut si monument i natyrës i karakterit botanik (në tekstin e mëtejshëm: Monumenti i Natyrës).

1.1. Monumenti i Natyrës ndodhet në pronën private të z.Kurtish Troni, ngastra kadastrale numër 00136-0, koordinatat **LAT:42.240248, LONG:21.236213**, në lartësinë mbidetare 520 m.

1.2. Trungu ka trashësi në perimetër prej 5 m, lartësi prej 25 m dhe një vjetërsi prej rreth 500 vite.

1.3. Gjendja e tij tani për tani është e mirë.

2. Monumenti i Natyrës sipas IUCN-it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III- të, Natural Monument/ Natural Landmark –Monument i Natyrës.

2.1. Për monumentin e natyrës përcaktohet regjimi regjimi mbrojtës i shkallës së III-të, në të cilin përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat në Monumentin e Natyrës ndalohet:

2.1.1. Prerja e trungut, thyrja (krasitja) e degëve,mbledhja e gjetheve,

2.1.2. Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur,

2.1.3. Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbrimit të sipërfaqës mbrojtur,

2.1.4. Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur ,

2.1.5. Ndryshimi i pamjes së sipërfaqes së mbrojtur ,

2.1.6. Hapja e varrezave në sipërfaqen e mbrojtur dhe

2.1.7. Çdo lloj aktiviteti tjetër i cili mund të shkaktojë ndryshimin apo dëmtimin e Monumentit të Natyrës.

2.2. Në Monumentin e Natyrës lejohen:

2.2.1. Të gjitha masat mbrojtëse biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës, nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për mbrojtjen e natyrës dhe në bazë të projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes së Monumentit të Natyrës.

3. Në zonën buferike të Monumentit të Natyrës ndalohet:

- 3.1.** Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi mbeturinave dhe mbetjeve tjera,
- 3.2.** Ndërrimi kulturës,
- 3.3.** Ngjitja e objekteve të cilat kanë ndikim në pengimin e pamjes së monumentit të natyrës.

4. Për zbatimin e masave mbrojtëse të monumentit të natyrës kujdeset Komuna e Kaçanikut.

4.1. Komuna është e detyruar :

- 4.1.1.** Monumentin e natyrës ta mbrojë dhe ta mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara mbrojtëse,
- 4.1.2.** Në rast të paraqitjes së ndryshimeve të cilat monumentin e natyrës mund ta shkatërrojnë ose ti dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tij menjëherë duhet ta lajmërojë Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës,
- 4.1.3.** Të bëjë shënimin e kufinjëve të monumentit të natyrës në pajtim me Rregulloren për shënimin e Zonave të Mbrojtura.

5. Planet hapësinore dhe urbanistike , projektet , baza ekonomiko-pyjore, hidroekonomike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit të Natyrës.

6. Ky Vendim pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokolit të autoritetit mbikqyrës-MAPL-së, si dhe pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

7. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike.

Me këtë Vendim njoftohen:

- 1. Kryetari i Komunës,
- 2. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit,
- 3. Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike,
- 4. Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, dhe
- 5. Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi

